




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinion i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA
dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opioni i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përvèç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte bërë pagesën në avansë për dy projekte kapitale me vlerë 38,155€, në munges të garacionit të performancës, dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave,
- A2 Në një rast tek kontrata me çmim për njësi, komuna kishte aplikuar kriterin +- 30% të vlerës së kontratës në kundërshtim me LPP-në;
- B1 Gjatë vitit 2023, nga thesari përmes përbartimit dhe vendimeve gjyqësore ishin realizuar pagesa në vlerë 256,011€ nga kategori ekonomike jo adekuate.
- C1 Në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 102,149€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.
- A3 Komuna nuk kishte arritur ta bëjë inspektimin (verifikimin) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Më gjërisisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimë ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimë ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit finansiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikimi i shpenzimeve, tejkalimi i kontratave publike kornizë, mungesa e sigurimit të garacionit të performancës me rastin e dhënies së avanseve, vonesa në pagesa, mos verifikimi i pronave te tatimi në pronë siç kërkohet me ligj, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit finansiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin finansiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondevë të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mossigurimi i garacionit të performancës dhe orarit të pagesave

Gjetja Sipas Nenit 13 të Ligjit nr. 08/I-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 parashev "Për pagesën e paradhënieve për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garacionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parashev punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë".

Te Kontrata Ndërtimi i QMF-së në Koshtovë faza e dytë me vlerë të kontratës 134,373€, si dhe te kontrata Ndërtimi QMF në Stanerg me vlerë të kontratës 119,996€, për këto projekte komuna kishte dhënë avansin 15% të vlerës së kontratave, por nuk ishte ofruar garacioni i performancës siç kërkohet me ligje, dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, për punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesa.

Shkaku i ndodhjes së kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme nga zyrtarët përgjegjës, që me rastin e dhënies së avansit ti kërkohet operatorit ekonomik që ta sjellë garacionin e performancës.

Ndikimi Mossigurimi i garacionit të performancës për paradhënie dhe i orarit të përcaktuar të pagesave i cili parashev punën që duhet kryer mundë të ndikoj që projekti të mos realizohet ashtu siç është paraparë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se për pagesat e bëra në paradhënie do të kërkoj sigurimin e garacionit e performancës dhe orarin e pagesave i cila njëkohësisht parashev punën që duhet kryer.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Tejkalimi i kontratës publike kornizë

Gjetja Neni 54.15 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, parashev "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rendësise së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%). Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Po ashtu neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parashev " Certifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshmë të një kontrate publike të jenë përbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".

Komuna me datën 27.12.2021, kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Furnizim me barna dhe material mjekësor për QKMF dhe AMF-të të ndarë në dy llote. Vlera e parashikuar për llot 1 ishte

465,000€. Sipas raportit të menaxherit të kontratës furnizimet e kryera për llot 1 janë 588,791€, të cilat edhe ishin paguar. Pra totali i tejkalimit të kontratës është 123,791€ apo 26.6%.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk kishte njohuri se kriteri +30% nuk mund të aplikohet tek ky lloj i kontratave.

Ndikimi Tejkalimi i kontratës ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të përmirësojë kontrollot për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave, dhe pagesat mos të bëhet nga certifikuesi pa u siguruar se janë respektuar të gjitha kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transakzionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2023, nga thesari përmes përbartimit dhe vendimeve gjyqësore ishin realizuar pagesa në vlerë 256,011€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre 192,938€ ishin realizuar nga kategoria e investimeve kapitale përderisa për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, ndërsa 63,074€ ishin realizuar përkompensimin e pagave prej tyre 54,759€ nga investimet kapitale ndërsa 8,315€ nga shpenzimet komunale.

Kjo ka ndodhur për shkak të ekzekutimit të pagesave nga thesari pa dakordim me komunën sidomos pagesave që lidhen me obligimet nga kontrata kolektive.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me MF-në që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorieve ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Vonesa në pagesën e Obligimeve

| | |
|-----------------------|---|
| Gjetja | Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. |
| | Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 102,149€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh. |
| | Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme, si dhe buxhetit të pamjaftueshëm. |
| Ndikimi | Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore. |
| Rekomandimi C1 | Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondevë për të sigruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave. |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

| | |
|-----------------------|---|
| Gjetja | Neni 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parashev që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna e Mitovicës kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 27,871 objekte dhe prona. Komuna në vitin 2023 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 2,414 objekteve apo me pak se 9%. Mos verifikimi i pronave kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit në departamentin e tatimit ne pronë dhe mos ndërmarrjes së masave nga menaxhmenti për angazhimin e stafit shtesë për ta kryer këtë proces. |
| Ndikimi | Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. |
| Rekomandimi A3 | Kryetari duhet të sigurojë arrijen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit finansiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për vitin 2023 ishin në vlerë prej 3,698,351€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 1,567,884€,(në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë). si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 2,130,467€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj, si dhe te hyra tjera ne vlerë 468€. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 231,469€, gjobat e Gjykatave 73,175€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 371€.

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pikë 1 definon: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij nenit.

- Nga analiza e data bazës qe i kemi bërë për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se zbritja ishte aplikuar tek 1,010 prona të cilat nuk ishin të regjistruara dhe nuk figuronin ne sistem si vendbanim parësor, si dhe;
- Në pesë (5) raste nga mostrat e testuara ishte aplikuar zbritja për pronat personave që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 2022 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal.

Kjo ka ndodhur për shkak te funksionimit jo të mirë të kontrolleve në departamentin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, dhe pa deklarim se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangje nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit eficencën, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të sigurar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 108,434,889€, pasurive jokapitale është 953,477€, si dhe e stoqeve 46,844€. Rritja e vlerës së pasurisë krahasuar me vitin paraprak ka ndodhur kryesisht për shkak te regjistrimit të pronave të cilat kanë qenë të paregjistruara në vitet paraprake.

Çështja B2 - Inventarizim jo i plotë i pasurive

| | |
|-----------------------|--|
| Gjetja | Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore përcakton në mënyrë të qartë mënyrën se si duhet të bëhet inventarizimi i pasurisë. Komuna kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë dhe i njëjti e ka hartuar një raport të inventarizimit ku janë përfshirë pasuritë me vlerë nën 1,000€ të drejtoreve komunale dhe disa institucioneve komunale, por jo edhe ato të shkollave dhe institucioneve shëndetësore. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive, dhe mungesës së kontrolleve të brendshme. |
| Ndikimi | Mos përfshirja e të gjitha pasurive në procesin e inventarizimit i pamundëson zyrtarit të pasurive krahasimin/ harmonizimin e regjistrave të pasurive me raportin e inventarizimit dhe për pasojë mund të sjellë deri te mungesa e korrigimeve eventuale të regjistrave. |
| Rekomandimi B2 | Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e caktuara për inventarizim, të përfshijnë të gjithë pasurinë e komunës. |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2023 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 14,564,307€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, tarifat e pa arkëtuara të tarifave komunale, të arkëtueshmet për mbledhjen e mbeturinave, të arkëtueshmet nga qiraja etj. Në kahasim me vitin paraprak LLA janë rritur për 1,007,432€.

Çështja B3 - Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

| | |
|-----------------------|--|
| Gjetja | Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë apo rregullore për secilin lloj të të hyrave. |
| | Komuna nuk po arrin të krijojë mekanizma për zvogëlimin e Llogarive të Arkëtushme të cilat kanë arritur vlerën totale në 14,564,307€. Sfida kryesore mbetet inkasimi i tatimit në pronë që në vitin 2023 ka arritur vlerën prej 8,963,983€, të hyrat nga tarifat komunale në vlerë 2,025,452€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 2,161,864€ etj. |
| | Nga gjashtë (6)mostra të testuar të qiradhënisë së pronave komunale kemi vërejtur se qiradhënsit shfrytëzojnë pronat me kontrata të skaduara deri në 10 vite, dhe nuk i kanë përbushur detyrimet sipas marrëveshjeve kontraktuale. Komuna gjatë vitit 2023 kishte dërguar tek përmabruesi 33 raste për arkëtimin e llogarive të tatimit. |
| | Rritja e LLA ka ardhur për shkak të veprimeve të pamjaftueshme të Komunës në drejtim të inkasimit të borxheve, neglizhencës së stafit dhe mos përcaktimit të saktë të personave/departamenteve përgjegjëse për menaxhimin e kontratave të qirasë. |
| Ndikimi | Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për arkëtimin e LLA, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. |
| Rekomandimi B3 | Kryetari duhet të adresojë problemet e lartpërmendura duke ndërmarrë masa ligjore ndaj borxhlinjve sipas kushteve të dakorduara, të trajtohen kontratat e skaduara sipas procedurave të parapara. |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) gjatë vitit 2023 kishte tre anëtarë të stafit-Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Komuna po ashtu ka themeluar komitetin e auditimit i cili është funksional. NjAB përveç planit strategjik kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2023 dhe deri në fund të vitit kishte finalizuar gjashtë raporte të Auditimit, aq sa ishin planifikuar. Komuna po ashtu ka të themeluar edhe Komitetin e Auditimit i cili ishte funksional dhe gjatë vitit kishte mbajtur 5 takime.

Çështja B4 - Zbatimi i ulët i rekondimeve të NJAB-së

| | |
|-----------------------|--|
| Gjetja | Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekondimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. |
| | Nga vlerësimi i zbatimit të rekondimeve të dhëna nga NjAB është vërejtur zbatim i ulët i rekondimeve. Nga gjithsejtë 32 rekondime të dhëna vetëm nëntë (9) rekondime ishin zbatuar, gjashtë (6) ishin në proces dhe 17 ishin të pazbatuara. |
| | Mos implementimi i rekondimeve të NjAB-së ndikon në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identikuara nga auditimi i brendshëm. |
| Ndikimi | Mos implementimi i rekondimeve të NjAB-së ndikon në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identikuara nga auditimi i brendshëm. |
| Rekomandimi B4 | Kryetari duhet të sigurojë se rekondimet e dala nga auditimi i brendshëm do të përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre. |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përbledhur për burimet e fondevet buxhetore, shpenzimin e fondevet dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondevet buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti filletar | Buxheti final ⁵ | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e fondevet | 25,011,350 | 29,075,399 | 26,800,882 | 21,820,579 | 22,394,096 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 21,337,980 | 23,331,433 | 22,142,266 | 18,275,865 | 19,306,154 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 0 | 0 | 179,614 | 60,955 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 1,413,636 | 1,345,468 | 1,326,326 | 715,326 |
| Të hyrat vetanake | 3,673,370 | 3,673,370 | 2,897,727 | 1,886,661 | 2,248,778 |
| Donacionet vendore | 0 | 108,391 | 29,237 | 10,687 | 45,555 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 548,568 | 386,186 | 141,426 | 17,328 |

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti filletar për 4,064,049€. Rritja ishte kryesisht si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar me vlerë 1,413,636€, nga grandi qeveritare në vlerë 1,993,454€, si dhe nga donacionet 656,959€.

Në vitin 2023 Komuna e Mitrovicës Jugore ka shpenzuar 92% të buxhetit përfundimtar ose 26,800,882€, ngashëm me vitin paraprak 2022 (92%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondevet sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti filletar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondevet sipas kategorive ekonomike | 25,011,350 | 29,075,399 | 26,800,882 | 21,820,579 | 22,394,096 |
| Pagat dhe mëditjet | 12,603,554 | 14,648,580 | 14,583,138 | 12,230,685 | 13,614,018 |
| Mallrat dhe shërbimet | 3,838,141 | 3,979,844 | 3,894,431 | 3,480,368 | 3,047,293 |
| Komunalitë | 610,100 | 610,882 | 487,812 | 486,757 | 466,332 |
| Subvencionet dhe transferet | 1,227,659 | 2,063,019 | 2,004,864 | 1,153,132 | 956,418 |
| Investimet Kapitale | 6,731,896 | 7,773,075 | 5,830,637 | 4,469,637 | 4,310,034 |


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,045,026€ kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, dhe Vendimet e Qeverisë së Kosovës për realizimin e ligjit të ri të pagave. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte mbi 99%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 141,703€ në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 98%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte afersisht i njëjtë me buxhetin fillestar me një rritje prej 782€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur mbi 80%.
- Buxheti final për Subvencione dhe transfere ishte rritur për 835,360€ në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar dhe granteve të donatorëve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 97% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 1,041,179€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 75%. Niveli i ulet i realizimit në këtë kategori ishte rezultat i vonesave ne realizimin e procedurave të prokurimit ku tek disa procedura kishe ankesa në OSHP.

Ku po i theksojmë disa prej kontratave si në vijim:

“Ndërtimi (Asfaltimi) I rrugëve në fshatin Kçiq” vlera e parashikuar 180,000€,
 “Zgjerimi I rrjetit të kanalizimit, pastrami I kanalizimit, pusetave dhe shtratit të lumenjëve në Qytet dhe Periferi” vlera e parashikuar 550,000€, “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në Iliridë” vlera e parashikuar 800,000€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për vitin 2023 ishin në vlerë prej 3,698,351€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 1,567,884€,(në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë). si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 2,130,467€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj, si dhe te hyra tjera ne vlerë 468€. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 231,469€, gjobat e Gjykatave 73,175€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 371€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillesatar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---------------------------|-----------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Totali i të hyrave | 3,673,370 | 3,673,370 | 3,698,351 | 2,996,807 | 3,271,712 |
| Të hyrat tatimore | 1,238,566 | 1,238,566 | 1,567,884 | 1,073,382 | 1,002,543 |
| Të hyrat jo tatimore | 2,434,804 | 2,434,804 | 2,129,999 | 1,923,352 | 2,207,385 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 468 | 72 | 61,784 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022, ka rezultuar në 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë në proces të zbatimit dhe katër (4) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarrë | Statusi |
|----|-------------------|--|--|-----------|
| 1. | Baza për opinion | Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet dhe të regjistrohen pasuritë nën 1,000€. | Komuna kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka zbatuar këtë rekomandim. | I zbatuar |

| | | | | |
|----|---------------------|---|--|------------------------|
| 2. | Baza për opinion | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit. | Krahasuar me vitin paraprak vlera e pagesave të realizuara me vendime gjyqësore/ përbartimore ka rënë dukshëm. Megjithatë disa pagesa janë realizuar në thesari bazuar ne vendime gjyqësore nga kode dhe kategori ekonomike jo adekuate. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 3. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të përgatisin kontrata adekuate të cilat edhe do të respektohen në përpikëri nga menaxherët e kontratave. Si dhe, të sigurojë zbatim të procedurave të përgjithshme për procedimin e pagesave, që parandalojnë parregullsitë e lartpërmendura. | Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tillë. | I zbatuar |
| 4. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të ndërmerr masa të menjëherëshme për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënieve së subvencioneve të respektojnë kriteret e Ftesave Publike dhe të Rregullores, në mënyrë që të mos përsëriten devijimet e sipër përmendura. | Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tillë. | I zbatuar |
| 5. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se të gjithë menaxherët e emëruar të kontratave, të dakordohen me operatorët ekonomik në lidhje me ecurinë e kontratës, ku planet për menaxhimin e kontratës të nënshkruhet nga të dyja palët. | Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tillë. | I zbatuar |
| 6. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e caktuara për inventarizim, të përfshijnë të gjithë pasurinë e komunës. | Ky rekomandim nuk është zbatuar, mangësi të njëjta janë vërejtur edhe këtë vitë. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|-----|-------------------------|--|---|------------------------|
| 7. | Të hyrat | Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të kenë përfitim të disahershëm për vendbanim parësor. | Janë evidentuar dhe eliminuar përfituesit e dyfishtë të cilët kanë qenë të evidentuar në bazë të numrit personal në sistem, megjithatë ka raste të shumta kur tatimpaguesit nuk e kanë të regjistruar numrin personal dhe të njëjtë kanë mundësi të përfitojnë më shumë se një herë nga zbritja për banim primar. | Pjesërisht i zbatuar |
| 8. | Pagat dhe mëditjet | Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e papaguara ndaj punëtorëve të njihen dhe të raportohen në PFV. | Ky rekomandim është zbatuar. | I zbatuar |
| 9. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumat e paraqitura të LLA janë të sakta. | Ky rekomandim nuk është zbatuar. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 10. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore dhe të mos të shkaktohen obligime pa pasur mjete të mjaftueshme, me qëllim që mos të dëmtohet më tej buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit. | Komuna ka ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi duke zvogëluar numrin e rasteve të vonesa në pagesë në raport me vitin e kaluar, por, megjithatë nevojiten veprime shtesë për zbatimin e plotë të këtij rekomandimi. | Pjesërisht i zbatuar |
| 11. | Auditimi i Brendshëm | Kryetari duhet të sigurojë se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm do të përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësítë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre. | Nuk duket që janë marrë masa pasi që niveli i implementimit është ende i dobët. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipeve



Bahri Statovci, Anëtar i ekipeve



Kapllan Muhaxheri, Anëtar i ekipeve



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo


KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit



Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmojo se:

- Kam pranuar draft reportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për vitin 2023.
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment përmbytje të Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut
(Zyrtar Kryesor Administrativ)

Bedri Hamza

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financier në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tëresi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangje të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tëresi nuk përbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në reportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në reportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit pér të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit pér pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur pér këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shhangje të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opioni i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit pér pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur pér këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, pér të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen pér shkak të pamundësisë pér të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në reportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në reportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Parografi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo reportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo parografi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekondimimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekondimimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekondimimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.